# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 80

**Tiranë – E enjte, 12 maj 2016**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 4.5.2016 | Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar | 4495 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 4.5.2016 | Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit | 4495 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 4.5.2016 | Për një shtesë në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar | 4496 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 4.5.2016 | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, për kryerjen e konkursit rajonal për zhvillimin hapësinor të zonave "Shtigjet e lirisë" dhe "Korridori i gjelbër" | 4497 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 4.5.2016 | Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca studentore nr. 1" sh.a., Tiranë, "Trajtimi i studentëve nr. 2" sh.a., Tiranë dhe "Trajtimi i studentëve nr. 3" sh.a., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë | 4498 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 4.5.2016 | Për transferimin e aksioneve të shoqërive të tregjeve të tregtimit me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve te njësitë e vetëqeverisjes vendore | 4498 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 4.5.2016 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Albafilm sh.a. te Ministria e Kulturës, të objektit "Ish-laboratori i filmit", në zonën kadastrale 8130, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | 4499 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 4.5.2016 | Për krijimin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi" dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të godinës e të inventarit të mjeteve kryesore të Fototekës Kombëtare "Marubi" nga Ministria e Kulturës te ky muze ..... | 4501 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 4.5.2016 | Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve dhe pakësimin në volum në ngastrat pyjore të ekonomive pyjore "Gjadër-Mnelë", "Gomsiqe", "Karmë", "Shllak 2", "Qelëz", "Krrab-Bushat", "Koman-Karmë", "Dedaj-Buhot", "Bregu i Drinit", "Mërtur Guridhe", "Lumi i Berishës", në qarkun e Shkodrës dhe në ekonomitë pyjore dhe kullosore "Lugina e Tropojës", "Lugina e T'planit" në qarkun e Kukësit, për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kv "Shqipëri–Kosovë" (Vau i Dejës–Morinë) | 4501 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 4.5.2016 | Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënie me koncesion për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë..... | 4505 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 4.5.2016 | Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre..... | 4505 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 4.5.2016 | Për përcaktimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e modeleve..... | 4514 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 4.5.2016 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion dhe shtesë të teatrit "Andon Zako Çajupi", Korçë"..... | 4514 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 4.5.2016 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i Rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II"..... | 4515 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 4.5.2016 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Tregu industrial ushqimor - markata", Berat..... | 4520 |
| Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 4.5.2016 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit "Rindërtimi i banesës ku u ngrit flamuri në Korçë"..... | 4521 |

**VENDIM**
**Nr. 331, datë 4.5.2016**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "a", sipas shtesës, bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA**

**a)** Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida";**

1. TURKI; MUBARAK; ABDULLAH; AHMAD AL-BINALI
2. FAYSAL; AHMAD; BIN ALI; AL-ZAHRANI
3. TUAH; FEBRIËANSYAH
4. HUSAYN; JUAYTHINI
5. MUHAMMAD; SHOLEH; IBRAHIM

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM**
**Nr. 332, datë 4.5.2016**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT

1. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, në vijim "QKPA", organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit për çështjet e azilit dhe të refugjatëve, në vijim ministri, me seli në Tiranë.

2. Në këtë qendër akomodohet edhe i huaji, të cilit i është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre.

3. QKPA-ja ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të ministrisë që mbulon çështjet e azilit dhe të refugjatëve.

4. Drejtori i QKPA-së është drejtuesi i institucionit, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri dhe ka këto përgjegjësi:

a) Përfaqëson QKPA-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së Qendrës;

b) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të QKPA-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit;

c) Bashkëpunon me organe homologe dhe organizata të ndryshme të huaja për zgjidhjen efektive të problemeve, si dhe veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë";

ç) I raporton periodikisht drejtpërdrejt ministrit për kushtet e azilkërkuesve të akomoduar në këtë Qendër.

5. Përzgjedhja e programeve pedagogjike e edukuese, si dhe këshillimi ligjor falas për kategorinë e personave që trajton kjo qendër bëhen sipas legjislacionit për prokurimin publik.

6. Azilkërkuesit janë subjekte përfitimi të strehimit, ushqimit dhe të ndihmës financiare për nevoja emergjente vetjake, që ofron kjo qendër, si dhe të ndihmave humanitare, të cilat jepen nga persona fizikë ose juridikë, shqiptarë ose të huaj.

7. Mënyra dhe kriteret për përfitimin e strehimit, të ushqimit dhe të ndihmës financiare e humanitare, si dhe masa e këtyre ndihmave, sipas parashikimit të bërë në pikën 6, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

II. STEMA DHE VULA ZYRTARE E QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT

1. QKPA-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e QKPA-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet:

"Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit".

3. Vula e QKPA-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QKPA-së rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Struktura dhe organika e QKPA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

3. Rregullorja e brendshme e QKPA-së miratohet me urdhër të ministrit.

4. Vendimi nr. 262, datë 23.4.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimin e saj dhe për një shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 333, datë 4.5.2016

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas ndarjes "Ministria e Zhvillimit Urban", shtohet ndarja "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", me përcaktimet e paraqitura në

tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

3. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

| Institucioni Buxhetor | Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit | Numri maksimal i pagesave në një vit | Përbërja | | Shpërblim kryetari (Lekë) | Shpërblim anëtari (Lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kryetari | Nr. i Anëtareve | | |
| Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara | Këshilli Drejtues | 8 | 1 | 6 | 20.000 | 20.000 |

**VENDIM**
**Nr. 334, datë 4.5.2016**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN, PËR KRYERJEN E KONKURSIT RAJONAL PËR ZHVILLIMIN HAPËSINOR TË ZONAVE "SHTIGJET E LIRISË" DHE "KORRIDORI I GJELBËR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e vitit 2016, i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për kryerjen e konkursit rajonal për zhvillimin hapësinor të zonave "Shtigjet e lirisë", që shtrihet në territorin e rajoneve Gjakovë-Tropojë-Has, dhe "Korridori i gjelbër", që shtrihet ndërmjet territorit të rajoneve Prizren-Kukës.

2. Fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh të përdoret për mbulimin e çmimeve fituese të konkursit dhe, përkatësisht, për:

- 2 (dy) çmime të para – 900 000 (nëntëqind mijë) lekë secili;
- 2 (dy) çmime të dyta – 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë secili;
- 2 (dy) çmime të treta – 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë secili.

3. Fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Urban për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 335, datë 4.5.2016**

**PËR TRANSFERIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE AKSIONARE "REZIDENCA STUDENTORE NR. 1" SHA, TIRANË, "TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 2" SHA, TIRANË DHE "TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 3" SHA, TIRANË, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TE BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca studentore nr. 1" sh.a., Tiranë, "Trajtimi i studentëve nr. 2" sh.a., Tiranë, dhe "Trajtimi i studentëve nr. 3" sh.a., Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 336, datë 4.5.2016**

**PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË TREGJEVE TË TREGTIMIT ME SHUMICË DHE PAKICË TË FRUTA-PERIMEVE TE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 1.2, shkronja "a", dhe 28, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe të neneve 3 e 4, të ligjit 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e plotë të aksioneve të shoqërive shtetërore të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të hartojë dokumentacionin e duhur të ndryshimit të akteve të themelimit të shoqërive që do të transferohen tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe ta depozitojë për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Shoqëritë e tregjeve, që do të transferohen, të mbartin gjendjen e pasurisë së kapitalizuar, përfshirë elementet e aktivit dhe pasivit që figurojnë në bilancet e tyre. Ajo mbart të gjitha detyrimet kreditore dhe debitore të pasqyruara në bilanc.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, me zotërimin e pronësisë së aksioneve të shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, të zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilave u

transferohen aksionet e shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**Lidhja 1**

LISTA E SHOQËRIVE TË TREGJEVE AGROUSHQIMORE, AKSIONET E TË CILAVE DO TË TRANSFEROHEN NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

| Nr. | Emërtimi i shoqërisë | Statusi | Emri i njësisë së qeverisjes vendore | % e aksioneve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Vlorë | SHA | Bashkia Vlorë | 100 % |
| 2 | Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Shkodër | SHA | Bashkia Shkodër | 67.21% |
| 3 | Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Berat | SHA | Bashkia Berat | 100% |
| 4 | Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë, fruta perime-Kukës | SHA | Bashkia Kukës | 100% |

## VENDIM
## Nr. 338, datë 4.5.2016

## PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA ALBAFILM SHA TE MINISTRIA E KULTURËS, TË OBJEKTIT "ISH-LABORATORI I FILMIT", NË ZONËN KADASTRALE 8130, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Albafilm sh.a. te Ministria e Kulturës, të objektit "Ish-laboratori i filmit", në zonën kadastrale 8130, me sipërfaqe të përgjithshme 4 918 (katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) $m^2$, nga të cilat 1 420 (një mijë e katërqind e njëzet) $m^2$ sipërfaqe objekti dhe 3 498 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) $m^2$ sipërfaqe funksionale, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t'u përdorur për nevoja të Ministrisë së Kulturës.

2. Vendimi nr. 1445, datë 29.10.2008, i Këshillit të Ministrave, "Për dhënien me qira, pa konkurrim, "Top Channel" sh.a., të objektit "Ish-laboratori i filmit", në pronësi të Albafilm sh.a., Tiranë", revokohet.

3. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, i shtohet fondi prej 38 725 768 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e kontratës së qirasë me subjektin "Top Channel" sh.a.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia e Inventarizimit dhe

Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**



**VENDIM**
**Nr. 339, datë 4.5.2016**

**PËR KRIJIMIN E MUZEUT KOMBËTAR TË FOTOGRAFISË "MARUBI" DHE PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË GODINËS E TË INVENTARIT TË MJETEVE KRYESORE TË FOTOTEKËS KOMBËTARE "MARUBI" NGA MINISTRIA E KULTURËS TE KY MUZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1 e 12, pika 3, të ligjit nr. 9386, datë 4.3.2005, "Për muzetë", të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e shtetit për vitin 2016", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi", me seli në Shkodër, si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Kulturës.

2. Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" ushtron veprimtarinë e tij si institucion i specializuar muzeor, arkivor në fushën e fotografisë.

3. Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" ka të drejtë të krijojë fondacione në bashkëpunim me entitete të tjera juridike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kalimin në përgjegjësi administrimi të godinës e të inventarit të mjeteve kryesore të Fototekës Kombëtare "Marubi", nga Ministria e Kulturës te Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi".

5. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi' miratohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Fondet për realizimin e shpenzimeve, si dhe numri i punonjësve të miratuar për buxhetin e vitin 2016, për Fototekën Kombëtare "Marubi" i kalojnë Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi".

7. Numri i punonjësve të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi" bëhet 10 veta.

8. Numri i punonjësve rezervë, i parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit, reduktohet me 5 veta, duke e çuar numrin rezervë të punonjësve në 24 veta.

9. Në programin "Trashëgimi", të grupit buxhetor "Ministria e Kulturës", në buxhetin e miratuar për vitin 2016, shtohet fondi prej 3 669 000 (tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", për Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi".

10. Fondi i shtuar sipas pikës 9, në shumën 3 669 000 (tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

11. Vendimi nr. 849, datë 19.12.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për funksionimin e Fototekës Kombëtare "Marubi" dhe për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Bashkia e Shkodrës Ministrisë së Kulturës", i ndryshuar, revokohet.

12. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 340, datë 4.5.2016**

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM NË NGASTRAT PYJORE TË EKONOMIVE PYJORE "GJADËR-MNELË", "GOMSIQE", "KARMË", "SHLLAK 2", "QELËZ", "KRRAB-BUSHAT", "KOMAN-KARMË", "DEDAJ-BUHOT", "BREGU I DRINIT", "MËRTUR GURIDHE", "LUMI I BERISHËS", NË QARKUN E SHKODRËS DHE NË EKONOMITË PYJORE DHE KULLOSORE "LUGINA E TROPOJËS", "LUGINA E T'PLANIT" NË QARKUN E KUKËSIT, PËR NDËRTIMIN E LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT 400 kv "SHQIPËRI–KOSOVË" (VAU I DEJËS–MORINË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe, të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të

Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore prej 2.4964 (dy pikë katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) ha në ekonomitë pyjore "Gjadër-Mnelë", "Gomsiqe", "Karmë", "Shllak 2", "Qelëz", "Krrab-Bushat", "Koman-Karmë", "Dedaj-Buhot", "Bregu i Drinit", "Mërtur Guridhe" dhe "Lumi i Berishës", në Qarkun e Shkodrës dhe në ekonomitë pyjore dhe kullosore "Lugina e Tropojës", "Lugina e T'planit", në Qarkun e Kukësit, që do të përdoren për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kv "Shqipëri–Kosovë" (Vau i Dejës–Morinë), të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe të pakësohet në volum. Tabela me të dhënat për ngastrat pyjore e kullosore dhe harta topografike me gjurmën e ndërtimit të linjës së tensionit jepen në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes së hequr dhe të volumit të lëndës drusore e të produkteve të tjera paguhen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST), në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., është i detyruar të rehabilitojë sipërfaqen pyjore sipas kushteve të lejes mjedisore, brenda vitit të parë të pyllëzojë me fondet e saj një sipërfaqe prej 3.62 (tre pikë gjashtëdhjetë e dy) ha fond pyjor dhe të përmirësojë 0.5 (zero pikë pesë) ha kullotë në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat lidhur me detyrimet, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëjnë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore/ kullosore" dhe e regjistrojnë në kategorinë "Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të bazamenteve të shtyllave të linjës së interkonjeksionit 400 kv "Shqipëri-Kosovë" (Vau i Dejës–Morinë).

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., njësitë e qeverisjes vendore ku kalon linja dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR QË HIQEN DHE PAKËSOHEN NË VOLUM NGA FONDI PYJOR PËR NDËRTIMIN E LINJËS 400 KV SHQIPËRI-KOSOVË (VAU DEJËS-MORINË) NË QARKUN SHKODËR dhe KUKËS NGA *OST***

**Lidhja 1**

| Nr. | *ID Prones* | *Ekonomia Pyjore* | *Ngastra* | *Administrimi* | *Sip. qe jepet ne perdorim nga fondi (ha)* | *Perdorimi Territorit* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SH29 0 109 | EP Gomsiqe | 109 | njqv | 0.04 | trungishte |
| 2 | SH29 0 110 | EP Gomsiqe | 110 | njqv | 0.05 | inproduktive |
| 3 | SH 29 038a | EP Gomsiqe | 38a | njqv | 0.02 | shkurre |
| 4 | SH29 0 039a | EP Gomsiqe | 39a | njqv | 0.01 | shkurre |
| 5 | SH29 0 041 | EP Gomsiqe | 41 | njqv | 0.02 | shkurre |
| 6 | SH29 0 043a | EP Gomsiqe | 43a | njqv | 0.03 | shkurre |
| 7 | SH29 0 022 | EP Gomsiqe | 22 | njqv | 0.02 | inproduktive |
| 8 | SH29 0 021a | EP Gomsiqe | 21a | njqv | 0.02 | cungishte |
| 9 | SH29 0 021b | EP Gomsiqe | 21b | njqv | 0.02 | cungishte |
| 10 | SH29 0 017 | EP Gomsiqe | 17 | njqv | 0.01 | shkurre |
| 11 | SH29 0 016 | EP Gomsiqe | 16 | njqv | 0.02 | cungishte |
| 12 | SH29 0 012b | EP Gomsiqe | 12b | njqv | 0.02 | shkurre |
| 13 | SH29 0 010b | EP Gomsiqe | 10b | njqv | 0.01 | inproduktive |
| 14 | SH29 0 010a | EP Gomsiqe | 10a | ministria mjedisi | 0.02 | cungishte |
| 15 | SH29 0 004b | EP Gomsiqe | 4b | njqv | 0.03 | cungishte |
| 16 | SH29 0 003b | EP Gomsiqe | 3b | njqv | 0.02 | cungishte |
| 17 | SH34 0 001 | EP Karme | 1 | njqv | 0.01 | cungishte |
| 18 | SH34 0 002 | EP Karme | 2 | njqv | 0.01 | cungishte |
| 19 | SH34 0 003 | EP Karme | 3 | njqv | 0.03 | cungishte |
| 20 | SH34 0 006 | EP Karme | 6 | njqv | 0.02 | shkurre |
| 21 | SH34 0 005 | EP Karme | 5 | njqv | 0.02 | cungishte |
| 22 | SH34 0 0014 | EP Karme | 14 | njqv | 0.03 | shkurre |
| 23 | SH65 0 142a | EP Shllak | 142a | njqv | 0.02 | trungishte |
| 24 | SH65 0 143a | EP Shllak | 143a | njqv | 0.02 | trungishte |
| 25 | SH65 0 138 | EP Shllak | 138 | njqv | 0.03 | shkurre |
| 26 | SH65 0 134b | EP Shllak | 134b | ministria mjedisi | 0.01 | inproduktive |
| 27 | SH65 0 134a | EP Shllak | 134a | njqv | 0.01 | shkurre |
| 28 | SH65 0 135b | EP Shllak | 135b | ministria mjedisi | 0.03 | inproduktive |
| 29 | SH37 0 049a | EP.Koman-Karme | 49a | ministria mjedisi | 0.016 | trungishte |
| 30 | SH37 0 048b | EP.Koman-Karme | 48b | ministria mjedisi | 0.0518 | trungishte |
| 31 | SH37 0 018b | EP.Koman-Karme | 18b | ministria mjedisi | 0.02 | inproduktive |
| 32 | SH37 0 017b | EP.Koman-Karme | 17b | ministria mjedisi | 0.04 | trungishte |
| 33 | SH37 0 017a | EP.Koman-Karme | 17a | ministria mjedisi | 0.04 | inproduktive |
| 34 | SH37 0 006b | EP.Koman-Karme | 6b | ministria mjedisi | 0.02 | cungishte |
| 35 | SH37 0 006a | EP.Koman-Karme | 6a | ministria mjedisi | 0.01 | trungishte |
| 36 | SH21 0 092a | EP.Dedaj_ Bohot | 92a | njqv | 0.05 | shkurre |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 37 | SH21 0 092b | EP.Dedaj_ Bohot | 92b | njqv | 0.03 | trungishte |
| 38 | SH21 0 092a | EP.Dedaj_ Bohot | 92a | njqv | 0.02 | trungishte |
| 39 | SH21 0 105c | EP.Dedaj_ Bohot | 105c | njqv | 0.05 | trungishte |
| 40 | SH59 0 010d | EP.Qelez | 10d | njqv | 0.07 | trungishte |
| 41 | SH59 0 010e | EP.Qelez | 10/e | ministria mjedisi | 0.01 | shkurre |
| 42 | SH59 0 013b | EP.Qelez | 13/b | ministria mjedisi | 0.02 | trungishte |
| 43 | SH59 0 051b | EP.Qelez | 51/b | ministria mjedisi | 0.02 | cungishte |
| 44 | SH59 0 055a | EP.Qelez | 55/a | njqv | 0.01 | trungishte |
| 45 | SH39 0 004b | EP Krrabe Bushat | 4b | njqv | 0.02 | shkurre |
| 46 | SH39 0 004a | EP Krrabe Bushat | 4a | njqv | 0.01 | trungishte |
| 47 | SH59 0 057 | EP.Qelez | 57 | njqv | 0.01 | trungishte |
| 48 | SH59 0 059 | EP.Qelez | 59 | njqv | 0.03 | cungishte |
| 49 | SH59 0 065a | EP.Qelez | 65a | njqv | 0.16 | cungishte |
| 50 | SH59 0 072a | EP.Qelez | 72a | njqv | 0.02 | cungishte |
| 51 | SH59 0 075c | EP.Qelez | 75c | ministria mjedisi | 0.01 | shkurre |
| 52 | SH52 0 014a | EP.Lumi i Berishes | 14a | njqv | 0.01 | trungishte |
| 53 | SH52 0 015b | EP.Lumi i Berishes | 15b | njqv | 0.03 | inproduktive |
| 54 | SH52 0 016b | EP.Lumi i Berishes | 16b | ministria mjedisi | 0.02 | inproduktive |
| 55 | SH52 0 017a | EP.Lumi i Berishes | 17a | njqv | 0.014 | trungishte |
| 56 | SH52 0 019a | EP.Lumi i Berishes | 19a | njqv | 0.15 | trungishte |
| 57 | SH52 0 020a | EP.Lumi i Berishes | 20a | njqv | 0.01 | trungishte |
| 58 | SH52 0 021a | EP.Lumi i Berishes | 21a | njqv | 0.02 | cungishte |
| 59 | SH5200022b | EP.Lumi i Berishes | 22b | ministria mjedisi | 0.03 | inproduktive |
| 60 | SH52 0 023a | EP.Lumi i Berishes | 23a | ministria mjedisi | 0.01 | trungishte |
| 61 | SH52 0 024a | EP.Lumi i Berishes | 24a | ministria mjedisi | 0.03 | inproduktive |
| 62 | SH55 0 048 | EP Mertur Guri | 48 | ministria mjedisi | 0.03 | trungishte |
| 63 | SH55 0 046a | EP Mertur Guri | 46a | ministria mjedisi | 0.03 | trungishte |
| 64 | SH55 0 042a | EP Mertur Guri | 42a | ministria mjedisi | 0.03 | trungishte |
| 65 | SH55 0 041 | EP Mertur Guri | 41 | ministria mjedisi | 0.02 | trungishte |
| 66 | SH55 0 038 | EP Mertur Guri | 38 | ministria mjedisi | 0.02 | trungishte |
| 67 | SH55 0 024a | EP Mertur Guri | 24a | ministria mjedisi | 0.02 | trungishte |
| 68 | SH12 0 051b | EP.Bregu i Drinit | 51b | njqv | 0.01 | trungishte |
| 69 | SH12 0 049a | EP.Bregu i Drinit | 49a | ministria mjedisi | 0.02 | trungishte |
| 70 | SH12 0 048a | EP.Bregu i Drinit | 48a | njqv | 0.02 | trungishte |
| 71 | SH12 0 047b | EP.Bregu i Drinit | 47b | njqv | 0.05 | cungishte |
| 72 | SH12 0 070a | EP.Bregu i Drinit | 70a | njqv | 0.02 | trungishte |
| 73 | SH12 0 073b | EP.Bregu i Drinit | 73b | njqv | 0.04 | trungishte |
| 74 | SH12 0 075a | EP.Bregu i Drinit | 75a | njqv | 0.01 | cungishte |
| 75 | SH12 0 076 | EP.Bregu i Drinit | 76 | njqv | 0.04 | cungishte |
| 76 | SH12 0 077b | EP.Bregu i Drinit | 77b | njqv | 0.04 | cungishte |
| | **TOTALI SHKODER** | | | | **2.0714** | |
| 77 | KU30 00 163b | "Lugina e Tropojës" | 163b | ministria mjedisi | 0.018 | kullote |
| 78 | KU30 00 164b | "Lugina e Tropojës" | 164/b | njqv | 0.011 | kullote |
| 79 | KU30 00 167 | "Lugina e Tropojës" | 167 | njqv | 0.031 | kullote |
| 80 | KU30 00 169a | "Lugina e Tropojës" | 169/a | njqv | 0.014 | cungishte |
| 81 | KU30 00 169b | "Lugina e Tropojës" | 169/b | njqv | 0.013 | kullote |
| 82 | KU30 00 172 | "Lugina e Tropojës" | 172 | njqv | 0.027 | kullote |
| 83 | KU30 00 276 | "Lugina e Tropojës" | 276 | ministria mjedisi | 0.025 | kullote |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 84 | KU30 00 277 | "Lugina e Tropojës" | 277 | ministria mjedisi | 0.017 | kullote |
| 85 | KU29 00 001b | "Lugina e T'planit" | 1b | ministria mjedisi | 0.016 | inproduktive |
| 86 | KU29 00 003b | "Lugina e T'planit" | 3b | ministria mjedisi | 0.039 | inproduktive |
| 87 | KU29 00 068b | "Lugina e T'planit" | 68b | njqv | 0.016 | kullote |
| 88 | KU29 00 124b | "Lugina e T'planit" | 124/b | ministria mjedisi | 0.016 | inproduktive |
| 89 | KU29 00 125 | "Lugina e T'planit" | 125 | ministria mjedisi | 0.028 | cungishte |
| 90 | KU29 00 134 | "Lugina e T'planit" | 134 | ministria mjedisi | 0.088 | kullote |
| 91 | KU29 00 136a | | 136/a | njqv | 0.016 | cungishte |
| 92 | KU29 00 137a | | 137/a | njqv | 0.027 | cungishte |
| 93 | KU29 00 137d | | 137/d | ministria mjedisi | 0.023 | inproduktive |
| | **TOTALI KUKES** | | | | **0.425** | |
| | **GJTHSEJ SHKODER+KUKES** | | | | **2.4964** | |

**VENDIM**
**Nr. 341, datë 4.5.2016**

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIE ME KONCESION PËR NDËRTIMIN E ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë "*Building Construction & Green Energy*" për rezultatin teknik e financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë.

2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 342, datë 4.5.2016**

**PËR MIRATIMIN E KUFIJVE TERRITORIALË E HIDROGRAFIKË TË BASENEVE UJORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE QENDRËN E PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË SECILIT PREJ TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" e "b", të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të administrimit të burimeve ujore, ndahet në gjashtë basene ujore, me qendrat përkatëse, si më poshtë vijon:

a) Baseni ujor Drin–Bunë, me qendër në Shkodër;

b) Baseni ujor Mat, me qendër në Lezhë;

c) Baseni ujor Ishëm–Erzen, me qendër në Tiranë;

ç) Baseni ujor Shkumbin, me qendër në Elbasan;

d) Baseni ujor Seman, me qendër në Fier;

dh) Baseni ujor Vjosë, me qendër në Vlorë.

2. Përcaktimi i kufijve territorialë të çdo baseni është sipas hartës administrative, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përcaktimi i kufijve hidrografikë të çdo baseni është sipas hartave respektive të çdo baseni ujor, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Administrimi i integruar i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë, në nivel baseni ujor, të kryhet mbi bazën e kufijve të rinj territorialë, të përcaktuar nga analiza e kufijve hidrografikë, sipas hartave bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Për çdo basen ujor funksionon Agjencia e Basenit Ujor (ABU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

6. Për çdo basen ujor funksionon Këshilli i Basenit Ujor (KBU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për administrimin e burimeve ujore.

7. Numri i anëtarëve për këshillat e basenit ujor të jetë, si më poshtë vijon:

a) Baseni ujor Drin–Bunë 23 anëtarë;
b Baseni ujor Mat 15 anëtarë;
c) Baseni ujor Ishëm–Erzen 21 anëtarë;
ç) Baseni ujor Shkumbin 17 anëtarë;
d) Baseni ujor Seman 29 anëtarë;
dh) Baseni ujor Vjosë 27 anëtarë.

8. Kryetari i KBU-së të jetë prefekti i prefekturës më të madhe të qarkut në të cilin ndodhet basenin ujor, i cili do të jetë në këtë funksion për aq kohë sa ushtron detyrën si prefekt.

9. Nënkryetari i KBU-së të zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujor.

10. Sekretari i KBU-së të jetë drejtuesi i Agjencisë së Basenit Ujor, i emëruar nga ministri përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore.

11. Përbërja e anëtarëve të këshillave të gjashtë baseneve ujore të jetë, si më poshtë vijon:

11.1 Këshilli i Basenit ujor Drin–Bunë:

11.1.1 Prefekti i Shkodrës - kryetar.

11.1.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Malësi e Madhe 1 anëtar;
ii) Tropojë 1 anëtar;
iii) Shkodër 1 anëtar;
iv) Fushë-Arrës 1 anëtar;
v) Has 1 anëtar;
vi) Vau i Dejës 1 anëtar;
vii) Pukë 1 anëtar;
viii) Kukës 1 anëtar;
ix) Dibër 1 anëtar;
x) Lezhë 1 anëtar;
xi) Bulqizë 1 anëtar;
xii) Librazhd 1 anëtar;
xiii) Pogradec 1 anëtar.

11.1.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoria e zonave të zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.1.4 Grupet e interesit për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (1 anëtar i shoqatave, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.2 Këshilli i Basenit ujor Mat:

11.2.1 Prefekti i Lezhës - kryetar.

11.2.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Mirditë 1 anëtar;
ii) Kurbin 1 anëtar;
iii) Mat 1 anëtar;
iv) Klos 1 anëtar;
v) Fushë-Arrës 1 anëtar;
vi) Pukë 1 anëtar;
vii) Lezhë 1 anëtar;
viii) Bulqizë 1 anëtar.

11.2.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.2.4 Grupet e interesit për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

i) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.3 Këshilli i Basenit ujor Ishëm–Erzen:

11.3.1 Prefekti i Tiranës - kryetar.

11.3.2 Drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Krujë 1 anëtar;
ii) Durrës 1 anëtar;
iii) Vorë 1 anëtar;
iv) Tiranë 1 anëtar;
v) Shijak 1 anëtar;
vi) Kamzë 1 anëtar;
vii) Kurbin 1 anëtar.

11.3.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoria e zonave të mbrojtura (1 anëtar, 1 miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.3.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (2 anëtarë të shoqatave mjedisore, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (3 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.4 Këshilli i Basenit ujor Shkumbin:

11.4.1 Prefekti i Elbasanit - kryetar.

11.4.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Librazhd 1 anëtar;
ii) Elbasan 1 anëtar;
iii) Rrogozhinë 1 anëtar;
iv) Kavajë 1 anëtar;
v) Peqin 1 anëtar;
vi) Pogradec 1 anëtar;
vii) Përrenjas 1 anëtar;
viii) Divjakë 1 anëtar.

11.4.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Administrata e zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.4.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergjinë dhe industrinë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.5 Këshilli i Basenit ujor Seman:

11.5.1 Prefekti i Fierit - kryetar.

11.5.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Divjakë 1 anëtar;
ii) Lushnjë 1 anëtar;
iii) Belsh 1 anëtar;
iv) Cërrik 1 anëtar;
v) Gramsh 1 anëtar;
vi) Kuçovë 1 anëtar;
vii) Ura-Vajgurore 1 anëtar;
viii) Roskovec 1 anëtar;
ix) Patos 1 anëtar;
x) Fier 1 anëtar;
xi) Pustec 1 anëtar;
xii) Maliq 1 anëtar;
xiii) Berat 1 anëtar;
xiv) Korçë 1 anëtar;
xv) Devoll 1 anëtar;
xvi) Skrapar 1 anëtar;
xvii) Poliçan 1 anëtar;
xviii) Kolonjë 1 anëtar;
xix) Elbasan 1 anëtar;
xx) Mallakastër 1 anëtar.

11.5.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Administrata e zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.5.4 Grupe interesi për:

